


Tregtia e jashtme e mallrave

Qershor 2018

Tiranë, më 17 Korrik 2018: Në Qershor 2018 eksportet e mallrave arritën vlerën 27 mld lekë, duke u rritur me 17,8 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u ulur me 11,9 %, në krahasim me Maj 2018. Importet e mallrave arritën vlerën 54 mld lekë, duke u ulur me 5,0 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 4,9 %, në krahasim me Maj 2018. Deficiti tregtar i këtij muaji është 27 mld lekë, duke u ulur me 20,0 %, krahasuar me Qershor 2017 dhe duke u rritur me 3,1 %, në krahasim me Maj 2018.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2018 eksportet e mallrave arritën vlerën 158 mld lekë, duke u rritur me 18,3 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 309 mld lekë, duke u rritur me 4,7 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 151 mld lekë, duke u ulur me 6,6 %, krahasuar me 2017.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Rritja vjetore e eksporteve prej 17,8 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +8,9 pikë përqindje “Materiale ndërtimi dhe metale” me +4,5 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +1,7 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar negativisht grupi: “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” me -0,1 pikë përqindje.

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Qershor 2018




Eksportet, gjatë këtij gjashtëmujori janë rritur me 18,3 %, krahasuar me një vit më parë. Në ndryshimin vjetor të eksporteve nuk ka ndikuar negativisht asnjë grup. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +5,9 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +4,5 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +4,0 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Ulja vjetore e importeve prej 5,0 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Ushqime, pije, duhan” me -2,0 me pikë përqindje, “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me -1,5 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,0 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Prodhime druri dhe letre” me +0,04 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupevenë ndryshimin vjetor të importeve, Qershor 2018



Si gjashtëmujor, importet janë rritur me 4,7 %, krahasuar me gjashtëmujorin 2017. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +2,1 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +1,9 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +0,4 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupi: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -0,4 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Qershor 2018, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Qershor 2017 janë: Italia (1,1 %), Kosova (37,5 %) dhe Spanja (70,9 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Kina (-7,8 %), Bullgaria (-4,6 %) dhe Bosnja dhe Hercegovina (-10,6 %) .

Gjatë këtij gjashtëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (5,1 %), Spanja (94,3 %) dhe Kosova (11,8 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Turqia (-12,2 %), Kina (-25,0 %), dhe Ukraina (-53,7 %).

Në muajin Qershor 2018, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Qershor 2017 janë: Greqia (8,9 %), Turqia (10,3 %) dhe Kina (3,7 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-2,2 %), Gjermania (-24,8 %) dhe Spanja (-10,4 %).

Gjatë këtij gjashtëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (2,9 %), Greqia (6,8 %) dhe Turqia (2,9 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Gjermania (-2,7 %), Shtetet e Bashkuara (-4,7 %) dhe Ukraina (-32,5 %).

Fig.4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Qershor 2018



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 68,0 %, të gjithë tregtisë. Në Qershor 2018, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 76,3 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 63,9 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (35,6 %), Greqia (8,3 %), Gjermania (6,2 %) dhe Turqia (6,1 %).

Shkëmbimet tregtare, për gjashtëmujorin e parë 2018, me vendet e BE zënë 67,6 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Qershor 2018, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 77,2 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 62,7 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (35,6 %), Greqia (7,0 %), Gjermania (6,8 %) dhe Kina (5,9 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2016	01 - 16	16	-7,8	35	-1,0	-18	47,0
	02 - 16	18	-4,4	42	7,6	-24	42,0
	03 - 16	19	-12,7	47	5,6	-28	41,2
	04 - 16	21	1,7	52	19	-31	40,7
	05 - 16	21	-14,8	52	16,7	-31	39,6
	06 - 16	23	-6,4	52	6,2	-29	43,5
	Jan - Qershor 16	118	-7,7	279	9,3	-162	42,1
2017	01 - 17	19	15,6	35	0,9	-16	53,8
	02 - 17	20	14,2	44	5,1	-24	45,7
	03 - 17	24	22,0	54	14,9	-30	43,8
	04 - 17	24	13,7	50	-3,9	-26	48,1
	05 - 17	24	18,2	56	7,4	-31	43,6
	06 - 17	23	-0,1	57	9,2	34	39,7
	Jan - Qershor 17	134	13,5	296	5,7	-162	45,2
2018	01 - 18	24	24,4	45	27,5	-21	52,5
	02 - 18	24	18,8	46	4,4	-22	52,0
	03 - 18	27	14,6	55	2,5	-28	49,0
	04 - 18	27	11,3	53	5,2	-26	50,9
	05 - 18	30	24,3	57	1,9	-27	53,2
	06 - 18	27	17,8	54	-5,0	-27	49,2
	Jan - Qershor 18	158	18,3	309	4,7	-151	51,1

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)

	Eksporte				Importe			
	Qershor 17	Qershor 18	Jan.- Qer. 2017	Jan.- Qer2018	Qershor 17	Qershor 18	Jan.- Qer. 2017	Jan.- Qer2018
Vendet e BE-së	17.673	20.270	102552	122030	36.868	34.511	185.756	193.857
Austri	99	148	780	915	710	494	2.815	3.303
Mbretëri e Bashkuar	64	70	211	432	481	575	2.673	2.933
Gjermani	936	1.195	5.445	7.043	5.006	3.765	25.566	24.879
Greqi	994	1.142	5.919	6.862	5.094	5.547	24.024	25.658
Itali	12.329	12.464	72.641	76.327	16.612	16.242	87.380	89.876
Spanjë	1.183	2.022	6.514	12.656	1.379	1.236	6.334	6.513
Kroaci	105	67	412	426	617	365	2.133	2.793
Të tjera të BE-së	1.963	3.162	10.630	17.369	6.970	6.287	34.831	37.901
Kinë	287	265	4.493	3.369	4.103	4.256	22.258	24.002
Kosovë	1.849	2.543	9.976	11.155	723	698	3.832	3.857
Maqedonia	667	716	3.900	4.029	805	836	4.008	4.381
Rusi	-	7	37	18	758	886	4.520	5.371
SHBA	297	461	1.306	2.402	812	639	4.747	4.522
Turqi	165	254	1.002	880	4.253	4.693	24.450	25.166
Ukrainë	30	31	271	125	192	430	1.943	1.312
Zvicër	50	24	700	2.214	895	607	4.139	4.752
Të tjera	1.551	2.009	9.264	11.761	7.390	6.421	39.852	42.115
Gjithsej	22.571	26.580	133.501	157.982	56.800	53.977	295.505	309.335

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Qershor 17	Qershor 18	Jan.- Qer. 2017	Jan.- Qer2018	Qershor 17	Qershor 18	Jan.- Qer. 2017	Jan.- Qer2018
Gjithsej	22.571	26.580	133.501	157.982	56.800	53.977	295.505	309.335
Ushqime, pije, duhan	2.654	2.905	13.638	15.672	9.756	8.627	50.858	51.626
Minerale, lëndë djegëse, en. el.	2.766	4.768	22.887	30.765	4.718	4.688	25.223	30.928
Produkte kimike dhe plastike	388	462	2.276	2.779	7.840	7.782	43.413	43.380
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	286	267	1.511	1.517	2.005	1.930	9.622	10.056
Prodhime druri dhe letre	635	675	3.708	4.286	2.014	2.035	11.007	11.745
Tekstile dhe këpucë	10.268	10.652	57.886	63.286	7.969	7.936	42.772	44.031
Materiale ndërtimi dhe metale	3.557	4.577	21.067	27.091	7.861	7.321	38.661	37.421
Makineri, pajisje dhe pj. këmb.	1.286	1.635	6.975	8.421	12.350	11.522	62.135	68.227
Të tjera	732	640	3.553	4.165	2.286	2.137	11.814	11.921

Tab.4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë

(milionë lekë)

	Itali		Spanjë		Kosovë		Gjermani	
	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018
Gjithsej	72.641	76.327	6.514	12.656	9.976	11.155	5.445	7.043
Ushqim, pije duhan	3.179	3.781	395	557	1.524	1.444	665	658
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	4.897	1.793	5.046	10.487	2.855	2.005	693	1.306
Produkte kimike dhe plastike	666	759	3	25	637	619	9	13
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.172	1.154	12	132	2	4	0	3
Prodhime druri dhe letre	2.610	2.988	3	284	171	219	52	74
Tekstile dhe këpucë	45.791	49.045	850	1.065	64	53	2.781	3.743
Materiale ndërtimi dhe metale	8.375	9.661	200	92	3.842	5.849	697	346
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	4.270	5.160	1	4	333	346	425	627
Të tjera	1.681	1.986	5	9	548	615	124	274

Tab.5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë

(milionë lekë)

	Itali		Greqi		Turqi		Gjermani	
	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018
Gjithsej	87.380	89.876	24.024	25.658	24.450	25.166	25.566	24.879
Ushqim, pije duhan	9.016	8.818	6.735	7.670	2.872	2.902	1.939	2.246
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	7.285	6.995	3.457	3.968	1.104	406	291	219
Produkte kimike dhe plastike	9.316	9.114	3.987	3.851	3.717	3.830	3.747	3.870
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	7.536	7.737	34	40	175	157	4	110
Prodhime druri dhe letre	3.147	3.599	1.390	1.505	1.562	1.484	388	368
Tekstile dhe këpucë	21.861	22.445	1.903	1.925	7.630	7.841	1.251	1.456
Materiale ndërtimi dhe metale	9.986	10.825	4.426	4.356	2.792	3.647	4.489	742
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	16.106	17.288	1.227	1.424	3.463	3.687	12.547	14.900
Të tjera	3.126	3.056	866	921	1.135	1.212	910	969

Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri